

Në bazë të nenit 18 të Ligjit për Shoqata dhe Fondacione ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 52/2010, 135/2011, 55/2016 dhe 239/2022), Kuvendi themelues i Shoqatës për zhvillim shoqëror "Për Tetovën" - Tetovë (në tekstin më poshtë: Shoqata) në seancën e mbajtur më 15 janar 2023, miratoi:

STATUTIN E Shoqatës për zhvillim shoqëror "Për Tetovën" - Tetovë

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Ky Statut rregullon: emërtimin, selinë, qëllimet e Shoqatës; aktivitetet me të cilat realizohen qëllimet; mënyrën e marrjes së vendimeve për anëtarësimin, përjashtimin dhe pushimin e anëtarësimin në Shoqatë; të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve; llojin e organeve dhe përbërjen e tyre; mënyrën e përzgjedhjes dhe shkarkimit; kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve në organe dhe mënyrën e marrjes së vendimeve; përfaqësimin sipas ligjit; mënyrën e krijimit dhe posedimit të mjeteve; mënyrën e miratimit të raporteve financiare dhe raporteve të tjera; mënyrën e realizimit të transparencës dhe përgjegjësisë në punë; mënyrën e sjelljes, ndryshimit dhe plotësimit të Statutit; mënyrën e vendimmarrjes për ndryshimet statutore dhe për pushimin e Shoqatës; mënyrën e sjelljes dhe miratimit të plan-programeve, administrimit të mjeteve dhe/ose të pasurisë në rast të pushimit të Shoqatës; format e brendshme organizative; mënyrën e sjelljes dhe miratimit të akteve të tjera; konfliktin e interesave; mënyrën e zgjidhjes së çështjeve kontestuese dhe çështjeve tjera të rëndësishme për punën e Shoqatës, si dhe të çështjeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 2

(1) Shoqata është Shoqatë qytetare që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për proceset demokratike. Shoqata është e përkushtuar që të marrë pjesë në vendimmarrje për çështjet që janë prioritet për qytetarët, si në nivel lokal, ashtu edhe në atë qendror. Shoqata synon të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët. Qëllimi i Shoqatës është të ndikojë në ndërgjegjësimin e qytetarëve përmes aktiviteteve të saj për përfshirje aktive në mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të njeriut, lirinë e shprehjes, ngritjen e respektit për zbatimin e përpiktë të ligjeve dhe rendit shoqëror, demokratizimin e proceseve vendimmarrëse, përmirësimin e kushteve të jetesës, duke u angazhuar në veprimtari të ndryshme lidhur me zhvillimin dhe avancimin e transparencës së organeve publike, avancimin e zhvillimit lokal urban dhe rural, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor duke siguruar mjedis, ujë dhe ajër të pastër, ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e një mjedisi të pastër dhe mënyrat se si mund të arrihet kjo, mënyrat se si mund të ruhen hapësirat publike. Shoqata përmes aktiviteteve të saj do t'i ndërgjegjësojë qytetarët për rëndësinë e përfshirjes së drejtpërdrejtë dhe angazhimin e tyre në iniciativa për përpilimin e strategjive dhe politikave zhvillimore për mjedis të pastër.



(3) Emërtimi i Shoqatës në gjuhën maqedonase është: **Здруженије за општествен развој „За Тетово“ - Тетово.**

(4) Emërtimi i shkurtër i Shoqatës në gjuhën maqedonase është: **ЗЗТ - Тетово.**

(5) Motoja e Shoqatës në gjuhën shqipe është: **Drejtësi, Dinjitet dhe Jetë Cilësore.**

(6) Motoja e Shoqatës në gjuhën maqedonase është: **Праведност, Достоинство и Квалитетен Живот.**

Neni 6

(1) Selia e Shoqatës ndodhet në Tetovë, Rr. "Kuzman Josifovski - Pitu" Nr. 78. Vendimin e vendndodhjes së selisë e merr Kuvendi.

Neni 7

(1) Shoqata e ka vulën e vet si dhe vulën katrore.

(2) Vula e Shoqatës është në formë të rrumbullakët dhe në të është shkruar teksti në gjuhën shqipe: Shoqata për zhvillim shoqëror "Për Tetovën" - Tetovë dhe teksti në gjuhën maqedonase me alfabet cirilik: **Здруженије за општествен развој „За Тетово“ - Тетово.**

(3) Vula katrore e Shoqatës është në formë të drejtkëndëshit dhe në të është shkruar teksti: Shoqata për zhvillim shoqëror "Për Tetovën" - Tetovë, **Здруженије за општествен развој „За Тетово“ – Тетово.** Në të figuron vendi i numrit të protokollit, data dhe shtojca.

(4) Përdorimin e vulës dhe të vulës katrore të Shoqatës e përcakton këshilli drejtues në përputhje me dispozitat ligjore.

III. QËLLIMET

Neni 8

(1) Qëllimi themelor i Shoqatës është avancimi i të drejtave dhe lirive të qytetarëve, përmirësimi i shërbimeve publike ndaj qytetarëve, lobimi për përmirësimin e kornizës ligjore që do të mundësojë përmirësimin e demokracisë lokale, përmirësimin dhe avancimin e kushteve për jetë, pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në vendimmarrje për prioritetet e shoqërisë, ngritja e vetëdijes publike dhe ndikimi i diskursit intelektual, me qëllim që të krijohen kushte në hapësirën publike, për avancimin e qëllimeve themelore të Shoqatës.

Neni 9

(1) Qëllimet afatgjate të Shoqatës janë:



që kanë të bëjnë me avancimin e qëllimeve të Shoqatës.

Neni 11

(1) Parimet mbi të cilat mbështetet puna e Shoqatës janë: liria e shprehjes, pjesëmarrja aktive në vendimmarrje, pavarësia, karakteri publik i punës dhe transparenca, puna ismat në jetën publike, pjesëmarrja, partneriteti, toleranca, qëndrueshmëria dhe mundësitë e barabarta.

Neni 12

(1) Shoqata vepron në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Shoqata vepron edhe në nivel ndërkombëtar, në përputhje me politikën dhe me strategjinë e saj të përgjithshme.

IV. ANËTARËSIMI

Neni 13

(1) Anëtar i Shoqatës mund të jetë çdo qytetar me zotësi të plotë për të vepruar, i cili anëtarësohet në mënyrë vullnetare dhe i pranon qëllimet e Shoqatës të përcaktuara me këtë Statut.

(2) Aplikimi i kandidatit bëhet duke plotësuar formularin e përgatitur nga Shoqata dhe ia parashtron për shqyrtim komisionit për anëtarësim.

(3) Komisioni për Anëtarësim pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga vet kandidati, vendos për çdo anëtarësim në mënyrë individuale.

(4) Komisioni për anëtarësim njofton këshillin drejtues për anëtarësimet e reja.

(5) Shoqata, nëpërmjet komisionit për anëtarësim, është e detyruar t'i përgjigjet kërkesës së kandidatit brenda dy javësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

(6) Këshilli drejtues i cakton formën dhe përmbajtjen e të dhënave që duhet të dorëzohen nga anëtarët e ri gjatë anëtarësimit.

(7) Anëtarët e ri detyrohen të dorëzojnë një dokument identifikues të vlefshëm (letërnjoftim ose pasaportë), me qëllim që të verifikohet identiteti i tyre.

(8) Anëtarësimi fillon kur anëtari regjistrohet në Regjistrin e anëtarëve të Shoqatës.

Neni 14



(6) Lajmërimi i largimit të anëtarit shpallet në kanalet për komunikim të Shoqatës.

Neni 17

(1) Personi që humbet anëtarësimin në Shoqatë, njëkohësisht humb të gjitha pozitat tjera që ekzistojnë brenda Shoqatës. Këto pozita hapen për plotësim në bazë të procedurave të rregullta.

V. ORGANET E Shoqatës

Neni 18

(1) Organet e Shoqatës si trupa të përhershëm janë: kuvendi, këshilli drejtues, këshilli mbikëqyrës, kryetari, nënkryetari dhe komisioni për anëtarësim.

(2) Kryetari dhe nënkryetari janë përfaqësues të Shoqatës.

(3) Organet e Shoqatës zgjidhen sipas mënyrës së përcaktuar me këtë Statut. Kandidatët për anëtarë të organeve të Shoqatës duhet të jenë persona me integritet, me aftësi të dëshmuara profesionale dhe që ndajnë vlerat, qëllimet e Shoqatës.

(4) Anëtarët e organeve të Shoqatës veprojnë në kapacitet personal, të pavarur dhe vendosin sipas bindjeve të veta në përputhje me qëllimet dhe synimet e Shoqatës.

(5) Anëtarët që kanë lidhje familjare të brezit të parë, përpos Kuvendit, nuk mund të veprojnë në organin e njëjtë të Shoqatës.

1. Kuvendi

Neni 19

(1) Kuvendi është organi më i lartë i Shoqatës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqatës.

(2) Kuvendi:

(a) miraton Statutin, programin dhe aktet e tjera të Shoqatës;

(b) miraton raportin vjetor të punës dhe raportin financiar;

(c) vendos për ndryshimin e qëllimeve të Shoqatës;



(2) Kuvendi vendos me votim të hapur për të gjitha çështjet.

(3) Kuvendi vendos me votim të fshehtë vetëm për zgjedhjen dhe shkarkimin e kryetarit, të nënkryetarit, të anëtarëve të këshillit drejtues, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe anëtarëve të komisionit për anëtarësim.

(4) Anëtarët mund të marrin pjesë në votim edhe nëpërmjet telekonferencës.

(5) Kuvendi mund të vendos edhe nëpërmjet listës postare në adresën elektronike zyrtare të Shoqatës. Kur votimi bëhet në këtë mënyrë, supozohet se të gjithë anëtarët janë të pranishëm në seancë.

Neni 23

(1) Për punën e Kuvendit mbahet procesverbal që përmban të dhënat e përcaktuara me rregulloren e punës.

(2) Procesverbal mbahet nga mbajtësi i procesverbalit dhe verifikohet nga kryetari si dhe kryesuesi i Kuvendit.

(3) Procesverbal shpallet në kanalet e komunikimit të Shoqatës, jo më vonë se 10 ditë pas mbledhjes së Kuvendit. Të gjithë anëtarët e Shoqatës kanë qasje të plotë në procesverbalin e Kuvendit.

4) Secili anëtar i pranishëm në punën e Kuvendit ka të drejtë në shtesa dhe sugjerime në procesverbalin e shpërndarë, në afat prej dy ditësh nga dita e shpalljes së Procesverbalit në kanalet e komunikimit. Përndryshe, Procesverbal konsiderohet i pranueshëm nga anëtarët.

2. Përfaqësuesit

Neni 24

(1) Përfaqësuesit e Shoqatës janë kryetari dhe nënkryetari.

(2) Përfaqësuesi nuk mund të vendosë vetë dhe përfaqëson vetëm vendimet dhe politikat e Shoqatës, të cilat janë marrë nga organet e saja të parashikuara në këtë Statut.

(3) Në rast të dënimit që i shqiptohet Përfaqësuesit nga autoritet shtetërore, Përfaqësuesi kompensohet në mënyrë të barabartë nga të gjithë anëtarët e Shoqatës që kanë marrë pjesë në vendimin, për të cilin shqiptohet dënimi ndaj Përfaqësuesit. Anëtarët që kanë votuar kundër, përmbajtur ose nuk kanë qenë të pranishëm gjatë marrjes së vendimit nuk detyrohen të kompensojnë Përfaqësuesin.

2.1 Kryetari:



(a) për ligjshmërinë, rregullsinë dhe kryerjen në kohë të punëve të Shoqatës, si dhe për sigurimin e kushteve të punës, në përputhje me ligjet, Statutin dhe aktet e përgjithshme të Shoqatës;

(b) për përgatitjen dhe paraqitjen në kohë, në mënyrë objektive dhe të saktë të raporteve financiare;

(c) për administrimin dhe ndjekjen e rreziqeve, ndaj të cilave është e ekspozuar Shoqata.

(3) Kryetari, në kuadër të të drejtave dhe autorizimeve të veta, mund t'i japë ndonjë personi tjetër autorizim me shkrim, për të ndërmarrë veprime të caktuara juridike, si dhe për ta përfaqësuar Shoqatën para organeve të jurisprudencës dhe organeve tjera. Përmbajtja, lloji, vëllimi dhe kohëzgjatja e autorizimit përcaktohet nga kryetari.

(4) Kryetari, pas miratimit nga Kuvendi, por jo më vonë se 30 prilli, në faqen e internetit të Shoqatës, shpall programet vjetore për vitin aktual, si dhe raportet financiare për vitin paraprak.

(5) Punët profesionale dhe tekniko-administrative për nevojat e Shoqatës i kryen kryetari i Shoqatës.

Neni 26

(1) Kryetari dhe nënkryetari zgjidhen nga anëtarët e kuvendit.

(2) Votimi bazohet në mekanizmin e Votës së Vetme të Transferueshme (Single Transferable Vote ose STV). Gjatë votimit, anëtarët do të renditin kandidatët sipas preferencave të tyre.

(3) Pozita e kryetarit dhe nënkryetarit do t'u ofrohen anëtarëve sipas renditjes STV. Në rastin e votimit për kryetar dhe nënkryetar brenda të njëjtit sistem STV, kryetari, në krahasim me nënkryetarin, duhet të jetë në një rang më të lartë.

(4) Kryetari dhe nënkryetari janë persona, të drejtat, autorizimet dhe përgjegjësitë e të cilëve ndërlidhen me udhëheqjen e Shoqatës, si dhe me përfaqësimin e Shoqatës, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut.

(5) Mandati i kryetarit dhe i nënkryetarit zgjat katër vite dhe kufizohet në jo më shumë se dy mandate pa të drejtë rizgjedhjeje.

(6) Kryetari dhe nënkryetari janë anëtarë të këshillit drejtues.

Neni 27

(1) Në mungesë të kryetarit, rolin e tij e merr nënkryetari.

Neni 28

(1) Kryetari ose nënkryetari mund të përjashtohen prej pozitave të tyre me dy të tretat e votave të



(2) Këshilli drejtues mban të paktën katër mbledhje në vit.

(3) Mbledhjet e këshillit drejtues thirren nga kryetari i këshillit drejtues me nismën e tij ose me kërkesën e së paku tre anëtarëve të këshillit drejtues.

(4) Kryetari i këshillit drejtues ka për detyrë të thërrasë mbledhje brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

(5) Thirrja e mbledhjes bëhet më ftesë në të cilën theksohet koha dhe vendi i mbajtjes së mbledhjes, si dhe propozimi i rendit të ditës.

(6) Për punën e seancës mbahet procesverbal, të cilin e verifikojnë kryetari dhe një anëtar i këshillit drejtues.

(7) Vendimet e këshillit drejtues shpallen në kanalet e komunikimit të Shoqatës.

(8) Këshilli drejtues mund të marrë vendim nëse në seancë të këshillit drejtues merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit drejtues dhe vendimet miratohen nëse votojnë shumica e anëtarëve të pranishëm, por jo më pak se një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit drejtues.

Neni 32

(1) Anëtarët e këshillit drejtues zgjidhen nga anëtarët e Kuvendit, përmes mekanizmit të Votës së vetme të transferueshme.

(2) Vendet e zbrazëta të këshillit drejtues do të plotësohen sipas renditjes së fundit të STV.

Neni 33

(1) Anëtari i këshillit drejtues mund të shkarkohet nga pozita e tij, nëse për një gjë të tillë votojnë dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit drejtues.

4. Këshilli mbikëqyrës

Neni 34

(1) Këshilli mbikëqyrës është organ i Shoqatës, puna e të cilit lidhet me kontrollin e veprimtarisë së Shoqatës dhe organeve të saj.

(2) Këshilli mbikëqyrës përbëhet prej pesë anëtarëve.



Neni 36

(1) Anëtarët e këshillit mbikëqyrës zgjidhen nga anëtarët e Kuvendit, nëpërmjet mekanizmit të Votës së vetme të transferueshme.

(2) Vendet e zbrazëta të këshillit mbikëqyrës plotësohen sipas renditjes së fundit të siguruar me votimin STV.

Neni 37

(1) Anëtari i këshillit mbikëqyrës mund të shkarkohet nga pozita e tij, nëse për një gjë të tillë votojnë më shumë se dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

5. Komisioni për anëtarësim:

Neni 38

(1) Komisioni për anëtarësim përfaqëson organin e përhershëm të Shoqatës. Qëllimi i komisionit për anëtarësim është pranimi dhe përpunimi i kërkesave nga kandidatët për anëtarësim.

(2) Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë.

(3) Mandati i anëtarëve të komisionit zgjat katër vjet, me të drejtë rizgjedhjeje. (4) Anëtarët e komisionit nuk kanë përcaktim në numrin e mandateve që mund të rizgjidhen.

(5) Anëtarët e komisionit nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë të këshillit drejtues, ose të këshillit mbikëqyrës.

Neni 39

(1) Komisioni për anëtarësim:

(a) përgatit metodologjinë për shqyrtimin e kërkesave për anëtarësim.

(b) shqyrton aplikimet e kandidatëve për anëtarësim.

(c) mban komunikim të rregullt me kandidatët deri në momentin e marrjes së vendimit për anëtarësim.

(d) i paraqet vendimin e anëtarësimit këshillit drejtues, për anëtarësimet e reja brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për anëtarësim.



të Shoqatës të përcaktuara me këtë Statut dhe nuk mund të ndahet ndërmjet themeluesve, anëtarëve, anëtarëve të organeve, kryetarit, punonjësve, apo çdo personi tjetër të lidhur me ta.

Neni 44

- (1) Viti financiar përputhet me vitin kalendarik.
- (2) Masa dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve të Shoqatës përcaktohet çdo vit me planin financiar, në bazë të planit dhe programit vjetor.
- (3) Plani vjetor, duke përfshirë planin financiar, miratohet nga këshilli drejtues.
- (4) Plani vjetor miratohet në fund të vitit kalendarik për vitin pasardhës.
- (5) Nëse plani vjetor nuk miratohet në afatin e caktuar nga paragrafi 4 i këtij neni, financimi do të bëhet sipas planit vjetor të vitit paraprak.

Neni 45

- (1) Shoqata mban kontabilitet, paraqet llogaritë vjetore dhe mban shënime për veprimtarinë financiare.

Neni 46

- (1) Shoqata përgatit raport vjetor, llogari vjetore dhe raporte financiare në përputhje me ligjin, këtë Statut dhe me aktet e përgjithshme të Shoqatës.
- (2) Raporti vjetor përbëhet nga raporti i të arriturave dhe raporti financiar. Përmbajtja e raportit vjetor dhe raportit financiar është në përputhje me ligjin dhe Statutin e Shoqatës.
- (3) Kryetari është përgjegjës për raportin vjetor, për llogarinë vjetore dhe për raportet financiare, përkatësisht për përgatitjen dhe për nënshkrimin e tyre.
- (4) Nëse buxheti vjetor i Shoqatës është mbi 20,000.00 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi mund të vendosë që të bëhet auditim i pavarur vjetor i veprimtarisë financiare. Nëse buxheti është mbi 100,000.00 euro në kundërvlerë në denarë sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, auditimi duhet të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.
- (5) Raportin vjetor dhe raportin financiar për vitin paraprak, Kuvendi e miraton deri më 31 mars të vitit kalendarik vijues, përkatësisht në afatin e caktuar me ligj. Raporti vjetor dhe raporti financiar për vitin paraardhës publikohen në faqen e internetit të Shoqatës, jo më vonë se data 30 prill të vitit kalendarik vijues.



(e) në rast të ndryshimit të Statutit, i cili parashikon pushimin e ekzistimit;

(f) është marrë vendim nga gjykata kompetente;

(g) në rast falimentimi, ose

(h) në rast të zbatimit të likuidimit.

Neni 51

(1) Në rast pushimi të Shoqatës, pasuria dhe mjetet që mbeten pas shlyerjes së detyrimeve, do të jenë në dispozicion të Bibliotekës së Tetovës. Biblioteka e Tetovës do t'i shfrytëzojë fondet e Shoqatës për të blerë libra për nevojat e Bibliotekës së qytetit të Tetovës.

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 52

(1) Interpretimin e dispozitave të këtij Statuti e bën Kuvendi, ndërsa ndërmjet dy seancave të kuvendit, këshilli drejtues.

Neni 53

(1) Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë siç ka qenë mënyra dhe procedura e miratimit të tij.

Neni 54

(1) Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të shpallet në kanalet e komunikimit të Shoqatës.

(2) Çdo anëtar do të ketë qasje të plotë në vendimet e miratuara, procesverbalet e verifikuara, regjistrin e anëtarëve dhe dokumentet e tjera të Shoqatës. këshilli drejtues vendos për mënyrën e komunikimit zyrtar të Shoqatës.

Vendi dhe data:

Tetovë, më 17.01.2023

Shoqata për zhvillim shoqëror "Për Tetovën" - Tetovë

Përfaqësuese:

